



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.27

2005

29 prill

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.217, datë 15.4.2005	Për përcaktimin e disa shërbimeve shëndetësore, spitalore, publike, për t'u dhënë me koncesion, me marrëveshje ose kontrata shfrytëzimi, administrimi apo mirëmbajtje..... 1035
Vendim i KM nr.236, datë 21.4.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.449, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave "Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"..... 1035
Vendim i KM nr.240, datë 21.4.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit"..... 1039
Vendim i KM nr.241, datë 21.4.2005	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale dhe për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave "Për ngritjen e Agjencisë së Urbanizimit të Zonave Informale"..... 1040
Vendim i KM nr.243, datë 21.4.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme dhe të kulturave të ndryshme bujqësore, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së re 110 kv, Elbasan-Cërrik-Ibë..... 1041
Vendim i KM nr.246, datë 21.4.2005	Për miratimin e planit të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale..... 1043

Vendim i KM
nr.254, datë 7.4.2005

Për njohjen ushtarakëve të Forcave të Armatosura si periudhë sigurimi të periudhës së trajtimit financiar, sipas vendimit nr.225, datë 29.5.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të ushtarakëve, që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura”.....	1057
Lista e noterëve që u është hequr leja e ushtrimit të profesionit...	1058

VENDIM
Nr.217, datë 15.4.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E DISA SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, SPITALORE, PUBLIKE,
PËR T'U DHËNË ME KONCESION, ME MARRËVESHJE OSE KONTRATA
SHFRYTËZIMI, ADMINISTRIMI APO MIRËMBAJTJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e shërbimeve shëndetësore, spitalore, publike, si të lavanderisë, pastrimit, kateringut, mirëmbajtjes së ndërtesave spitalore e të impianteve teknologjike të tyre dhe të parkimit të automjeteve, për t’u dhënë me koncesion, me marrëveshje ose kontrata të tjera shfrytëzimi, administrimi apo mirëmbajtje.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë, me cilësinë e organit shtetëror të autorizuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.236, datë 21.4.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.449, DATË 26.6.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TARIFAT NË SEKTORIN E PYJEVE DHE TË
KULLOTAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, të neneve 28 e 37 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor” dhe të nenit 25 të ligjit nr.7917, datë 13.4.1995 “Për kullotat dhe livadhet”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.449, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Lënda drusore të shitet në këmbë ose e asortuar në anë të rrugës, me ankand. Shitja e lëndës drusore në këmbë bëhet sipas tarifave bazë, të përcaktuara në lidhjet 1/a dhe 1/b, që i bashkëlidhen vendimit në fuqi, ndërsa shitja e lëndës drusore të asortuar në anë të rrugës, sipas çmimeve të tregut.”.

2. Pikat 8, 11, shkronja “a”, e 14 shkronja “b” të lidhjes 2, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, shfuqizohen dhe zëvendësohen me lidhjen 2/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Tarifat për përdorimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe tarifat për përdorimin e sipërfaqeve pyjore, kullosore dhe të tokave me bimësi pyjore, të përfshira në studimet e miratuara nga

KRRTRSH-ja, të jenë, përkatësisht, sipas lidhjeve 4/a dhe 4/c, që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.

4. Lidhja 4/a “Tarifat për përdorimin e pyjeve dhe kullotave për qëllime pushimi, turistike e të tjera”, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, shfuqizohet dhe zëvendësohet me lidhjen 4/a “Tarifat për përdorimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Pas lidhjes 4/b “Tarifat për ngritjen e kampingjeve, qendrave dhe objekteve të tjera të lëvizshme”, shtohet lidhja 4/c “Tarifat për përdorimin e sipërfaqeve pyjore, kullosore dhe të tokave me bimësi pyjore, të përfshira në studimet e miratuara nga KRRTRSH-ja”.

6. Pas lidhjes 5 shtohen lidhja 6 “Tarifat e shitjes së pemëve të Krishtlindjes dhe të Vitit të Ri” dhe lidhja 7 “Tarifat e shitjes së fidanëve, nga ripërtëritja natyrore, shpatullave, kalemave dhe degëve për buqeta”, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 2/a

TARIFAT E PRODHIMEVE TE DYTA

Nr.	Emërtimi	Njësia matjes	Tarifa lekë
1.	Prodhim qymyr druri në sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor	kv	100
2.	Nxjerrje dhe grumbullim, në fondin pyjor e kullosor:		
	a. Gurë, rërë dhe zhavorr	m ³	35
3.	Grumbullim në fondin pyjor:		
	a. Boçe të ndryshme	kv	200

Shënim: Tarifa e gërmës **a**, të pikës 2, të përdoret vetëm në rastin e grumbullimit të materialeve të ndërtimit nga banorët e zonave rurale, për nevojat e tyre vetiake.

TARIFAT PER PERDORIMIN E SIPERFAQEVE PYJORE DHE KULLOSORE

Nr.	Qëllimi I përdorimit	Koha e përdorimit	Tarfia (lekë/ha/vit), për		
			pyjet e lartë	pyjet e ulët, shkurret dhe kullotat	tokat me bimësi pyjore dhe sipërfaqet inproduktive
1. Ndërtim kënde lojrash, sportive, vendosje çadrash etj.		deri 3 vjet	500,000	400,000	320,000
		4-5 vjet	400,000	320,000	260,000
2. Vendosje antene të telefonisë fikse të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit etj.		deri 5 vjet	9,000,000	7,200,000	5,800,000
		6-10 vjet	8,000,000	6,400,000	5,100,000
		11-20 vjet	7,000,000	5,600,000	4,500,000
3. Nxjerrje dhe prodhim materiale inerte për ndërtim, tregëti, qëllime industriale ose përpunuese, direkt nga sipërfaqja (karrierë)		deri 5 vjet	450,000	430,000	410,000
		6-10 vjet	410,000	390,000	370,000
		11-20 vjet	370,000	350,000	330,000
4. Ndërtim objekte tregtie, bare, restorante, hotele, karburanti etj të kësaj natyre		deri 5 vjet	6,000,000	5,800,000	4,700,000
		6-10 vjet	5,800,000	4,700,000	3,800,000
5. Shpim-kërkim uji, gazi, nafte, shtrirje tubacionesh në sipërfaqe, ndërtim kanalesh etj		deri 5 vjet	200,000	160,000	130,000
		6-10 vjet	160,000	130,000	100,000
6. Punime gjeologo-minerare (gërmime dhe depozitime materiale në sipërfaqe), ngritje objekteve të ndryshme për realizimin e punimeve, etj, vetëm për sipërfaqet që zihen prej tyre.		deri 5 vjet	100,000	80,000	64,000
		6-10 vjet	80,000	64,000	51,000
		11-15 vjet	64,000	51,000	40,000
7. Ndërtim teleferik pasagjerësh ose për punime të ndryshme (stacionet, bazamanetet dhe objektet përkatëse)		deri 10 vjet	200,000	160,000	130,000
		11-20 vjet	160,000	130,000	110,000
8. Ndërtim rruge për lidhjen e sipërfaqes të dhënë në përdorim, me rrejtin rrugor ekzistues.		E njëjtë me atë të sipërfaqes së dhënë në përdorim	50,000	40,000	30,000
9. Ndërtim linje të tensionit të lartë		Për të gjithë kohën e funksionimit të linjës	30,000	-	-
10. Ndërtim rezervuarësh për zhvillimin e akuakulturës		deri 5 vjet	600,000	480,000	385,000
		6-10 vjet	480,000	385,000	310,000
11. Për mbarështrimin e flores dhe faunës së egër		1-10 vjet	20,000	18,000	15,000
		11-20 vjet	18,000	16,000	12,000
		21-30 vjet	16,000	14,000	10,000
12. Vendosje koshere bletësh		Për një sezon	500,000	500,000	500,000

Lidhja 4/c

TARIFAT PER PERDORIMIN E SIPERFAQEVE PYJORE, KULLOSORE
DHE TE TOKAVE ME BIMESI PYJORE, TE PERFSHIRA NE STUDIMET
E MIRATUAR NGA KRRTSH

Qëllimi i përdorimit	Tarifa (lekë/ha/vit):			
	Zona malore	Zona kodrinore	Zona fushore	Zona me përparësi zhvillimin e turizmit
Qendra ose komplekse pushimi, kurimi dhe turistike.	50,000	70,000	100,000	120,000

Lidhja 6

TARIFAT E SHITJES SE PEMEVE TE KRISHTLINDJEVE
DHE VITIT TE RI

Nr.ren.	Specifikimi	Njësia matjes	Tarifa (lekë)
1.	me lartësi deri në 1 m	copë	1000
2.	me lartësi mbi 1 deri 3 m	copë	2000
3.	me lartësi mbi 3 deri 5 m	copë	3000
4.	me lartësi mbi 5 m	copë	5000

TARIFAT E SHITJES SE FIDANAVE, NGA RIPERTERITJA NATYRORE,
SHPATULLA, KALEMAVE DHE DEGEVE PER BUQETA

Nr.ren.	Emertimi	Njësia matjes	Tarifa (lekë)
1.	Fidana, shpatulla dhe kalema:		
	- me moshë 1 vjeçare	copë	10
	- me moshë 2 vjeçare	copë	30
	- me moshë mbi 2 vjeçare	copë	50
2.	Degë të gjelbëra, me dhe pa lule, për buqeta	kv	100

VENDIM
Nr.240, datë 21.4.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.88, DATË 1.3.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “ PËR MIRATIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
TURIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “B” të pikës 1 të vendimit nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave, “Ksamili” zëvendësohet me “Territoret jashtë vijës kufizuese të Ksamilit”.
2. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.241, datë 21.4.2005

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT DHE

**URBANIZIMIT TË ZONAVE INFORMALE DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR.440, DATË 26.6.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NGRITJEN E
AGJENCISË SË URBANIZIMIT TË ZONAVE INFORMALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 13, pika 1 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Legalizimit dhe e Urbanizimit të Zonave Informale (ALUZI), (më poshtë agjencia), funksionon si pjesë e strukturës së ministrisë, që mbulon këtë fushë.

2. Agjencia është struktura përgjegjëse, që monitoron dhe ndjek zbatimin e legjislacionit në fushën e planifikimit të territorit dhe konkretisht për:

a) Legalizimin e ndërtimeve pa leje; b) urbanizimin e zonave informale; c) zhvillimin e zonave urbane të degraduara.

3. Agjencia drejtohet nga drejtori dhe në organikë ka specialistë, të cilët emërohen dhe lirohen nga ministri, që mbulon fushën e planifikimit të territorit, në përputhje me procedurat dhe kriteret e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

4. Agjencia kryen këto detyra:

a) Bashkëpunon dhe bashkërendon punën me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për zbatimin e ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”;

b) Studion dhe verifikon ecurinë e procesit të legalizimit dhe të urbanizimit të zonave informale, si dhe planifikon fondet buxhetore të KRRTRSH-së për financimin e këtij procesi;

c) Raporton, nëpërmjet sekretarisë teknike, në KRRTRSH për çdo fazë të procesit të legalizimit dhe të urbanizimit të zonave informale, si dhe propozon marrjen e masave konkrete;

ç) Harton dhe propozon për miratim në KRRTRSH kriteret e format urbanistike integruese për zhvillimin e zonave informale apo të zonave urbane të degraduara;

d) Kontrollon zbatimin e studimeve urbanistike të miratuara, sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, dhe i propozon KRRTRSH-së lëshimin e autorizimit për fillimin e legalizimeve në zonën informale përkatëse;

dh) Përcakton procedurat për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe ndjek zbatimin e tyre;

e) Propozon, mbështet dhe zbaton politikat e qeverisë për zhvillimin e zonave urbane të degraduara;

e) Bashkërendon punën me sekretarinë teknike të KRRTRSH-së për vlerësimin e propozimeve të njësive të qeverisjes vendore për zonat informale, sipas përcaktimit të nenit 8 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004;

f) Bashkërendon punën me njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të ligjit nr.8652, datë 31.7.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe me ISPU-në për hartimin e studimeve urbanistike të zonave informale, të veçanta, në zbatim të vendimit nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, të ndryshuar, dhe përgatit materialet për Këshillin e Ministrave, në përputhje me shkronjën “e” të nenit 8 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004.

5. Veprimtaria e brendshme e agjencisë rregullohet me rregulloren përkatëse të miratuar nga ministri, që mbulon fushën e planifikimit të territorit.

6. Në vendimin nr.440, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Agjencisë së Urbanizimit të Zonave Informale”, të bëhen këto ndryshime:

a) Emërtimi “Agjencia e Urbanizimit të Zonave Informale” të zëvendësohet me “Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale”;

b) Pikat 1, 2, 3, 4, 6 e 7, shfuqizohen.

7. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 243, datë 21.4.2005

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME DHE TË KULTURAVE TË NDRYSHME BUJQËSORE, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS SË RE 110 KV,
ELBASAN-CËRRRIK-IBË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme dhe të kulturave të ndryshme bujqësore, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës së re 110 kV, Elbasan-Cërrrik-Ibë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH, sh.a.-së.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, dhe pronarët e kulturave bujqësore të dëmtuara, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 304,33 m² tokë bujqësore arë dhe për kultura të ndryshme bujqësore, në shumën e përgjithshme prej 651 110 (gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e dhjetë) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga fondet e KESH sh.a.-së, të miratuara për koston lokale për shpronësimet.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 185 000 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë dhe të përballohet nga KESH, sh.a., kërkuesi për shpronësim.
6. Procedura e shpronësimit të fillojë brenda muajit maj 2005 dhe të përfundojë brenda tremujorit të katërt të po këtij viti.
7. Punimet për ndërtimin e kësaj linje të përfundojnë në qershor 2005.
8. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së dokumenteve të pronësisë, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999.
9. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INDUSTRIËS DHE ENERGJETIKËS**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË LINJËS SË RE 110 KV ELBASAN-CËRRRIK-IBË”.

**RRETHI : ELBASAN
KOMUNAT BRADASHESH DHE PAPËR,**

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore Arë

Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit të linjës: Kutura bujqësore, drufrutor, të mbjella, struktura vreshti.

Nr.	Emri	Mbiemri	Nr. i shtyllës që preket	Nr. kadastr. i parcelës	Sipërfaqja e tokës m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera në lekë	Toka e mbijellë me bimë në m ²	Lloji i kultivimeve bujqësore të dëmtuara, gjatë punimeve	Vlera në lekë për kult. bujqësore, të dëmtuara	Vlera totale në lekë e kompensimit të pronarit	Adresa sipas Komunes
1.	DALIP	TAFA	1	70	61,31	1000	61.310	870	jonxhe	31.320	92.630	Bradashesh
2.	DAUT	TAFA	2	201	19,45	1000	19.450	350	jonxhe	12.600	32.050	Bradashesh
3.	SALI	TAFA	2	201	15,75	1000	15.750	455	jonxhe, miser, hardhi	22.502	38.252	Bradashesh
4.	BAKI	PAPERRI	2	201	3,61	1000	3.610	108	miser	2.646	6.256	Bradashesh
5.	HEKTOR	LESHANAKU	3	201	7,92	1000	7.920	569	jonxhe	20.484	28.404	Bradashesh
6.	FATMIR	TUFA	3	201	3,96	1000	3.960	360	jonxhe	12.960	16.920	Bradashesh
7.	KUJTIM	SKENDERI	3	201	3,96	1000	3.960	340	jonxhe	12.240	16.200	Bradashesh
8.	HYSEN	ZAVALINA	4	201	12,91	1000	12.910	350	miser	8.648	21.558	Bradashesh
9.	KUJTIM	MYQELEFI	4	201	0	1000	0	353	miser	8.648	8.648	Bradashesh
10.	HYSEN	ZAVALINA	5	201	38,81	1000	38.810	0	0	0	38.810	Bradashesh
11.	AJAZ	IBRAHIMI	8	154	47,33	1000	47.330	696	jonxhe, fshese, hardhi	36.650	83.980	Bradashesh
12.	GANI	ÇELA	11	157	25,81	1000	25.810	0	0	0	25.810	Bradashesh
13.	KUJTIM	ZAVALINA	13	157	38,81	1000	38.810	756	miser	18.522	57.332	Bradashesh
14.	YLLI	LULI	1	114	24,7	800	19.760	330 m ² + 6, 25 m ² rrenje +3+4+6+3	miser, mur, rrush pjeshke, hurme shege	103.250	123.010	Paper
15.	SKENDER	DUHGA	0	0	0	0	0	150 m ² , 150 m ² , 13 m ² rrenje	miser, jonxhe, mur, rrush, hurme, kumbull, pjeshke	61.250	61.250	Paper
/	TOTALI	----			304,33 m ²	0	299.390	12,12,3,4		351.720	651.110	

Sqarime :
Shpenzime procedurale : 1. Publikime 165.000 (njëqindegjashatëdhjetëpesëmijë) lekë
2. Shpërbllim anetareve të komisionit 20.000 (njëzetëmijë) lekë

Vlefë totale e shpronësimit = 651.110 + 165.000 + 20.000 = 836.110 (tetëqindetridhjetëgjashtëmijë e njëqindedhjetë) lekë.

**VENDIM
Nr.246, datë 21.4.2005**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR REDUKTIMIN E EKONOMISË
INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për reduktimin e ekonomisë informale, sipas matricës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministratë dhe institucionet qendrore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

draft

Plani i Veprimit Për Reduktimin e Ekonomisë Informale

Objekti	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
Permiroimi dhe rregullimi i vlerësimeve statistike dhe të GDP-se		Instituti i Statistikave		
1. Permiroimi i identifikimit dhe matjes së ekonomisë informale në afat të shkurtër (2005 – 2006)	1.1. Nderimi i një metode të re, "metoda e input labour" për matjen e NOE (Ekonomia e pavezhuar) 1.2. Permiroimi i metodës së llogaritjes të treguesve të punësimit me të dhënat e LSMS (Sistemi i matjes së standardeve të jetesës) 1.3. Përshtatja e informacionit nga drejtoria e kontrollit të tatimeve për permiroimin e llogaritjeve të NOE 1.4. Përshtatja e informacionit nga inspektorati i punës për permiroimin e llogaritjeve të NOE	INSTAT	Dokumenti metodik	2005-2006
		INSTAT	Tregues të punësimit të përmësuar	2005-2006
		INSTAT+Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Formulari i ri për identifikimin e shtijëve të paraportuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike	2005-2006
		INSTAT+Inspektorati i Punës	Formulari i ri për identifikimin e të punësuarve të deklaruar sipas NVE	2005-2006

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
2. Përmirësimi i identifikimit dhe matjes së ekonomisë informale në afat të mesëm (2007 – 2009)	1.5. Ndërtimi i metodikës së input-output table	INSTAT		2005-2006
	1.6. Përmirësimi i cilësive së regjistrit statistikor	INSTAT	regjister ndërmarrjesh i azhurnuar	2005-2006
	1.7. Përmirësimi i bazës ligjore për sigurimin e informacionit për pasqyrat financiare (mundësisht të përfshihen PSZ)	INSTAT	a) përfshirja në Programin e Statistikave Zyrtare; ose b) MOU (memorandum mirekuptimi) me gjykatat	2005-2006
	1.8. Përmirësimi me personel shtesë të sektorit të llogarive kombëtare	INSTAT		2005-2006
	1.9. Përmirësimi i infrastrukurës teknike në përlogaritjen e GDP	INSTAT		2005-2006
	2.1. Vërtetimi për forcat e punës	INSTAT		2007-2009
	2.2. Zbatimi i metodikës së “input labour” në llogaritjen dhe vlerësimin e NOE			2007-2009
	2.3. Aplikimi i metodës së përmirësuar për të gjithë treguesit e serise kohore të GDP	INSTAT	Anketa	2007-2009

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati	
	2.4. Përmirësimi dhe analize e vecante për llogaritjen e komponenteve të GDP, për ndërmarrjet që paguajnë TVSH	INSTAT +DPT	NOE ,tregues të përmirësuar metodologjikisht	2007-2009	
	2.5. Analiza të detajuara të pagesave të deklaruara të TVSH dhe të pagesave të pritura të TVSH	INSTAT		2007-2009	
	2.6. Zbatimi i metodikës së input-output table, e cila do të mundësohet edhe me realizimin e objektivave të zhvillimit të programit kombëtar statistikor,5 vjeçar	INSTAT,(nuk ka lidhje me objektivat e projektit “Twinning”)		2007-2009	
	2.7. Transformimi i metodës egzistuese të matjes së NOE me koeficiente statistike në metode dinamike me koeficiente dinamike			2007-2009	
	2.8. Krijimi i një grupi ekspertësh të ekonomisë për të rinovuar koeficientet	INSTAT		2007-2009	
	2.9. Regjistrimi i përgjithshëm i njësive ekonomike jobujqesore			2007-2009	

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
Permiresimi i regjimit dhe administrimit te taksave dhe doganave		Ministria e Financave		
3. Përmirësimi i kuadrit ligjor fiskal	3.1. Permiresimi i procedurave te regjistrimit të biznesit	Ministria e Financave	Paketa Fiskale 2006	Tetor 2005
	3.2. Permiresimi i procedurave te licensimit		Paketa Fiskale 2007 – e punuar mbi bazën e këtyre rishikimeve	Tetor 2006
4. Rishikimi i nivelit të barrës fiskale dhe i kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	4.1. Analiza e nivelit të barrës (ligjore) fiskale	Ministria e Financave	Përgatitja e një materiali mbi nivelin e barrës fiskale në total dhe për cdo detyrim ligjor fiskal, mbi bazën e një analize krahësuese edhe me vendet e rajonit	Mars 2005
	4.2. Rishikimi i barrës për cdo burim tatimi dhe takse bazuar në rezultatet e analizës së barrës fiskale		Propozimi i ndërhjerve konkrete për nivelin e barrës sipas tatimeve dhe taksave	Qershor 2005

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
5. Forcimi i institucioneve të administratës fiskale (tatimeve dhe doganave)	5.1. Luftë kundër korrupsionit administrativ	Ministri i Shtetit për Koordinimin;	Zbatimi i matricës antikorrupsion (MSHK)	Afati i matricës antikorrupsion (MSHK)
	5.2. Gjetja e hapësirave të paketës ligjore fiskale të paqarta dhe rishikimi për përmirësim i tyre	Ministria e Financave	Përgatitja e raportit mbi rishikimin e paketës ligjore fiskale me rekomandimet përkatëse – paqartësitë ligjore	Qershor 2005
	5.3. Eliminimi i burokracisë në zbatimin e ligjit për procedurat fiskale	DPT, DPD	Zbatimi i matricës për heqjen e barrierave administrative (ME)	Afati i matricës për heqjen e barrierave administrative (ME)
6. Analizë e tatimit mbi fitimin, tatimin mbi biznesin e vogël dhe tatimit mbi vlerën e shtuar	6.1. Harmonizimi i këtyre tre taksave për të ulur mundësinë e shmangies së regjistrimit dhe pagimit të këtyre tatimeve sipas xhiros reale të taksapaguesve	Ministria e Financave Autoriteti mbikeqyres i sigurimeve	Propozimi për ndryshimin e nivelit të taksave	Qershor 2005
	6.2. Përmirësimi i kontrollit të Tatimi mbi Biznesin e Vogel, TVSH dhe Tatimi mbi Fitimin	DPT Autoriteti mbikeqyres i sigurimeve	Rezultatet e kontrollit, realizimi i të ardhurave nga TBV, TVSH, TMF	Raportim mujor mbi rezultatet e kontrollit

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
	6.3. Rishikimi (ulja) e normës së TFM (është miratuar ulja tashmë për vitin 2005 në 23% dhe 2006 në 20%) për të bërë më atraktiv investimet e huaja	Ministria e Ekonomisë	Propozimi mbi bazën e analizës së bërë për rishikimin e normës së TFM – Paketa fiskale 2007	Qershor 2005 / Tetor 2006
7. Analizë e aplikimit të TVSH-së	7.1. Vendosja e TVSH-së në ndërtim në 1 Janar 2006			
	7.2. Monitorimi i formulës dhe zbatimit të saj		Zbatimi i ligjit të TVSH-së	Janar 2006
8. Përmirësimi i sistemit (procedurat dhe kohës) të rimbursimit të tatimeve	8.1. Rimbursimi i TVSH-së	Ministria e Financave	Zbatimi i ligjit me formulën e re për procedurat e rimbursimit të TVSH dhe detyrimeve të tjera të paguara më tepër	Janar 2005
	8.2. Rimbursimi i detyrimeve fiskale të paguara më tepër	DPT	Raport me situatën e kërkesave dhe rimbursimeve të kryera	Raport mujor / tremujor
9. Reduktimi i "Cash-it" në ekonomi	9.1. Kalimi i rrugave dhe perfitimeve të tjera individuale të nepunësve shtetërore nëpërmjet sistemit bankar	Banka e Shqipërisë Ministria e Financave Bankat e nivelit të II Institucionet buxhetore	50 % e punonjësve buxhetore të paguhen nëpërmjet sistemit bankar	Shtator 2005

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
10. Krijimi i një sekretariati (zyrë shërbimi online dhe nonstop) për deklarimin e shkeljeve	10.1. Vendosija e shërbimit të sekretarisë telefonike për deklarimin e shkeljeve dhe rasteve abuzive dhe korruptive	Ministria e Financave	Ngritja e sekretarisë	Mars 2005
	10.2. Vendosija e shërbimit online për ofrimin e formularëve dhe dokumentave plotësues për deklarimin e tatimeve dhe informacione të tjera në shërbim të taksapaguesve	DPT	Aksesimi on line i informacionit	Prill 2005
	10.3. Bërja publike dhe shpërndarja dhe gjetja e lehtë e legjislacionit fiskal dhe udhëzuesve të administratës tatimore për publikun dhe biznesin në vecanti	DPD	Publikimi dhe shpërndarja e legjislacionit fiskal	Gusht 2005
11. Përmirësimi i kontrollit doganor	11.1. Përmirësimi i kontrollit të volumit, vlerës, sasisë, koston në kontrollin doganor – si element i abuzimit me pagimin dhe kërkesën për rimbursin të TVSh-së së paguar në doganë	Ministria e Financave DPD DPT	Raport i kontrollit doganor, masat e marra	Çdo tremujor

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
Identifikimi dhe mbledhja e sakte e kontributeve shoqerore		Ministria e Punes dhe Çështjeve Sociale		
12. Rritja e numrit të të siguruarve, nivelit të pagave si dhe studimi i tregut të punës dhe bilanceve të fuqisë punëtore	12.1. Organizimi i një konference kombëtare me partneret sociale dhe sensibilizimi i tyre për rendesinë që kontributet shoqerore mund të kenë në redukimin e ekonomisë informale në vend	Ministria e Punes dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Ekonomisë	Numri i rritur i të siguruarve dhe nivelit të pagave	2005
	12.2. Studim i situatës së tregut informal të punës në Shqipëri	Inspektorati Shtetëror i Punes Instituti i Sigurimeve Shoqerore Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve		Tremujori i parë 2006
	12.3. Studim për nivelin e pagave në sektorin privat, sipas degeve të ekonomisë dhe nivelin e rekomandueshëm që ato duhet të kenë gjatë viteve 2004 – 2010	I.S.SH D.P.T.		Tremujori i katërt 2005

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
	12.4. Evidentimi i numrit të te punesuarve ne fushen e ndertimit dhe i pagave faktike mbi te cilat jane siguruar punemarresit	I.SH.P I.S.SH D.P.T.		Tremujori i dyte 2005
	12.5. Perfshirja ne skeme e personave te pasiguarar te cilet jane konstatuar gjate ushtrimit te kontrolleve te perbashketa te ISHP dhe ISSH, ne firmat e ndertimit	I.SH.P I.S.SH D.P.T.		Tremujori i pare 2005
	12.6. Sensibilizimi i punedhenesve te fushes se ndertimit per ti siguruar punemarresit jo me pak se paga minimale qe ka rezultuar nga studimi nderdegesor	I.SH.P D.P.T.		Tremujori i pare 2006
	12.7. Propozime per ndryshime ne aktet ligjore dhe nenligjore te cilat bejne te detyrueshem sigurimin e punonjesve nga punemarresit	I.S.SH I.SH.P D.P.T.		2007 - 2010

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
13. Reduktimi i metejshem i kontributeve te KSS nga niveli shume i larte i tanishem nepermjet zgjerimit te takses baze	13.1. Studim per mundesine e reduktimit te metejshem te kontributeve	ISSH	Niveli i ulur i pagesave te sigurimeve shoqerore	Tremujori i pare 2006
	13.2. Studim per mundesine e zgjerimit te takses baze ose pagesave te diferencuara te kontributeve kundrejt realizimit te xhiros vjetore, me me pak se 8 milion leke	ISSH D.P.T.		Tremujori i trete 2006
	13.3. Propozime per ndryshime ne aktet ligjore dhe nenligjore te cilat bejne te detyrueshem sigurimin e punemarrtesve private xhiro vjetore nen 8 mil. leke, me nje page te percaktuar nga organet kompetente	I.SH.P I.S.SH D.P.T.		Tremujori i dyte 2007
	13.4. Propozime per ndryshime ne aktet ligjore dhe nenligjore te cilat bejne te detyrueshem sigurimin e te vetepunesuarve te diferencuar, sipas llojit te profesionit	I.SH.P I.S.SH D.P.T.		2007
	13.5. Propozim per permiresime ne ligjin e prokurimit	I.SH.P I.S.SH D.P.T.		2007

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
14. Përmirësimi i performancës në ekzekutimin e detyrave dhe krijtja e përgjegjësisë në ekzekutimin e detyrave nga inspektorët e taksave dhe të punës	14.1. Studim mbi nivelin dhe llojet e stimuljeve që mund të perdoren për stimulimin e inspektorëve të tatimeve dhe të ISHP	D.P.T. I.SH.P.		2006
	14.2. Hartimi i bazës ligjore për aplikimin e stimuljeve	D.P.T. I.SH.P.		2007
15. Futja e kullonave të treta efektive në bashkëpunim me siguruesit e pensioneve në sigurimet shoqërore	15.1. Plotësimi i akteve nënligjore për funksionimin e Inspektoriatit mbikqyres	I.SH.P.	Efektiviteti i Inspektoriatit mbikqyres	2007
	15.2. Hartimi i rregullores së licensimit	I.SH.P.		2007
	15.3. Studim lidhur me mundësitë e krijimit të fushave profesionale për punonjësit që punojnë në profesione të veshitura	I.SH.P. M.P.Ç.S. Ministritë e tjera		2006

Objekti	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
Permirësimi i mjedisit te biznesit dhe lehtësimi i procedurave për hapjen dhe zhvillimin e tij		Ministria e Ekonomisë		
16. Reduktimi i barrierave ndaj biznesit nëpërmjet zbatimit të Planit të Veprimit dhe rëkikimi i këtij procesi.	- Përfundimi i procesit të vete- vlerësimit ¹ në kuadër të redukimit të barrierave administrative të investimeve: 16.1. Organizimi i një tryeze për barrierat administrative në fushën e investimeve dhe prezantimi i rezultateve të vetëvlerësimit 16.2. Hartimi i draftit të planit të veprimit për redukimin e barrierave administrative në bazë të rezultateve të vetëvlerësimit	Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Nxirjes së Investimeve të Huaja me mbështetjen e FIAS, SOROS Task Force/ME, MF, MD, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Integritetit Europian	Prezantimi i rezultateve të vetëvlerësimit lidhur me impaktin e masave të ndërmara nga qeveria si dhe prezantimi i masave të reja. Përmirësimet me masa konkrete, institucione përgjegjëse dhe afate për zbatim.	Mars 2005 Mars 2005

¹ Procesi i vete-vlerësimit është një proces që do të përsëritet çdo dy vjet për të vlerësuar efektin e masave të zbatuara në përputhje me planin e veprimit si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme.

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
	16.3 . Amendimi i VKM 561, date 1.8.2003	Task Force/ME	Vendimi i Keshillit të Ministrave i ndryshuar	Maj-Qershor 2005
	16.4. Publikimi i rezultateve të vetvlerësimit dhe planit të ri për reduktimin e barrierave administrative	ME, ANIH me mbështetjen e donatorve.	Dokumenti i publikuar në shqip dhe anglisht.	Maj-Qershor 2005
	16.5. Ndjekja dhe kordinimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave të Planit të Veprimit	Task Force/ME		Vazhdimisht
	16.6. Zbatimi i masave të rekomanduara nga studimi për krijimin e zyrave të informimit publik për biznesin pranë ministrive të linjes	ME, MF, ANIH	Hapja e zyrave në Ministritë e linjes për informimin e biznesit	2005
17. Lehtësimi i procedurave të regjistrimit për biznesin	17.1. Amendimi i ligjit për shoqëritë tregtare	MD, ME/Keshilli Konsultativ i Biznesit	Rritja e shkallës së transparencës për treguesit ekonomik dhe financiare të shoqërive tregtare nëpërmjet publikimit të ketyre treguesve.	Tremujori i dytë 2005

Objektivi	Masa	Institucioni Përgjegjës	Treguesi Monitorimit	Afati
	17.2. Amendimi i ligjit për regjistrin tregtar	MD, ME, ANIH, KKB me mbështetjen e donatoreve	Shkurtimi i kohës dhe koston për regjistrimin e një biznesi si dhe cëlimimi i diferencimit ndërmjet investitoreve të huaj me ato lokal.	2005
	17.3. Realizimi i studimit për mundësinë e krijimit të sistemit one-stop shop për investitorët e huaj	ME, ANIH, KKB Me mbështetjen e donatoreve	Nxjerrja e Koston dhe prezantimi tek donatorët potencial për mundësi konkretizimi.	2005
	17.4. Realizimi i një studimi për mundësinë e krijimit të një programi kompjuterik për regjistrimin e bizneseve on-line	ME, Agjencia e zhvillimit të Ndermarrjeve të Vogla dhe të Mesme, KKB me mbështetjen e donatoreve	Nxjerrja e koston dhe zbatimi në praktike	2006-2007
	18.1. Përmirësimi i legjislativës organike dhe procedurave të krijuara për strukturat e gjyqësorëve dhe administrativë	MD, ME, KKB me mbështetjen e donatorëve	Përmirësimi i strukturave të apelimit dhe venia në jetë e "silent consent"	2006
18. Përmirësimi i procedurave të ankimit administrativ dhe zgjidhja e mosmarrveshjeve tregtare	18.2. Hartimi dhe miratimi i një ligji për arbitrazhin	MD, ME, KKB	Krijimi i gjykatës së arbitrazhit	2005
19. Përmirësimi i funksionit të KK të Biznesit	19.1. Realizimi i një studimi për krijimin e strukturës së re sekretariatit të KK të Biznesit	ME, KK i Biznesit	Krijimi i një strukture të veçantë brenda Ministrisë së Ekonomisë	2005-2006

VENDIM
Nr.254, datë 7.4.2005

**PËR NJOHJEN USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA SI PERIUDHË
SIGURIMI TË PERIUDHËS SË TRAJTIMIT FINANCIAR, SIPAS VENDIMIT NR.225,
DATË 29.5.1992 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË
USHTARAKËVE, QË DALIN NË LIRIM NGA ZBATIMI I REFORMËS NË STRUKTURAT
E FORCAVE TË ARMATOSURA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Periudha e përfitimit të trajtimit financiar nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, në përputhje me vendimin nr.225, datë 29.5.1992 të Këshillit të Ministrave, të njihet, duke filluar nga data 1.10.1993 e në vazhdim, si periudhë siguri, për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar.

2. Kontributet për këtë periudhë të llogariten mbi pagën mujore minimale dhe të përballohen nga Buxheti i Shtetit, duke filluar nga koha kur merret vendim për caktimin e pensionit të pleqërisë, të invaliditetit apo familjar dhe pasi të jetë përcaktuar periudha individuale, e nevojshme, si periudhë siguri për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti a familjar.

3. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke filluar nga viti 2006 e në vazhdim, të planifikojnë numrin e personave, që do të dalin në pension në vitin përkatës, si dhe fondet e nevojshme për kontributet e sigurimeve shoqërore.

4. Efektet financiare për vitin 2005 të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nga Buxheti i Shtetit, t’i shtohet, çdo vit, shuma e nevojshme për këtë qëllim.

6. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

NJOFTIM

Për të mundësuar vënien në dijeni të të gjitha institucioneve shtetërore dhe personave të tjerë

të interesuar për kryerjen e veprimeve noteriale dhe për vlefshmërinë e akteve noteriale, njoftojmë se në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994, i ndryshuar, me urdhra të Ministrit të Drejtësisë, u është hequr leja e ushtrimit të profesionit të noterit personave, të cilët paraqiten në listën e mëposhtme, sipas bashkive ku kanë pasur zyrat noteriale. Pas datës 30.4.2005, aktet e paraqitura me emrat dhe vultat e noterëve të kësaj liste, duhet të konsiderohen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e për rrjedhim të pavlefshme.

LISTA EMËRORE E NOTERËVE QË U HIQET LEJA E USHTRIMIT TË PROFESIONIT

Tiranë

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1. Jani Vasili | 9. Liri Gjoliku |
| 2. Leonora Halili | 10. Minella Milo |
| 3. Mehmet Isai | 11. Nikolla Cama |
| 4. Zeqine Sina | 12. Donika Konci |
| 5. Beqir Hasanbasha | 13. Agim Ibrahim |
| 6. Afrodhita Gjebero | 14. Gaqo Sheshi |
| 7. Violeta Shllaku | 15. Gjyltere Pustina |
| 8. Nezir Murati | |

Durrës

1. Nazmi Cankja
2. Milto Dado
3. Shpresa Cami

Elbasan

1. Pëllumb Barçi

Vlorë

1. Hasan Luçi
2. Brahim Aliko

Korçë

1. Sotiraq Qafëzezi

Laç

1. Nikoll Kola

Krujë

1. Qazim Mustafaj

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 29.4.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë